



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:270300

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875085

KPPP.nr. 2084/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “A.G. COSTRUZIONI” SH.P.K., me numër unik identifikues 810186983, me seli në Prishtinë rr. “Kalabri Bll.Urbanistik”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florim H. Shefqeti, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Swiss Work Construction” SH.P.K., me numër unik identifikues 810169252, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lutfi Tahiri, avokat nga Prishtina, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.775/23, i lejuar me datë 03.11.2023, nga Përmbartuesi Privat, Irfan I. Kërçagu në Prishtinë, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Swiss Work Construction” SH.P.K., dhe Urdhrit Përmbartimor P.nr.775/23 të datës 03.11.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 208€ në emër të përpilimit propozimit për përmbartim dhe shumën prej 208€ në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit “A.G. COSTRUZIONI” SH.P.K., mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës 22-SHV01-001-56 e datës 01.10.2022 në shumën prej 3,279.99€, Faturës 22-SHV01-001-65 e datës 01.11.2022 në shumën prej 3,520€, Faturës 23-SHV01-001-5 e datës 01.02.2023 në shumën prej

1,600€, Faturës 23-SHV01-001-11 e datës 01.03.2023 në shumën prej 2,560€, Faturës 23-SHV01-001-18 e datës 01.04.2023 në shumën prej 3,360€, Faturës 23-SHV01-001-26 e datës 01.05.2023 në shumën prej 3,928€, Faturës 23-SHV01-001-28 e datës 01.06.2023 në shumën prej 4,000€, Faturës 23-SHV01-001-37 e datës 01.07.2023 në shumën prej 3,000€, Faturës 23-SHV01-001-42 e datës 01.08.2023 në shumën prej 2,100€, Faturës 23-SHV01-001-44 e datës 01.09.2023 në shumën prej 1,460.00€ dhe Faturës 23-SHV01-001-47 e datës 01.10.2023 në shumën prej 730.00€ me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 29,537.99€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore nën kërcënimin e përmbaremit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbaremi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare, sekuestrimin, e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbaremit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbareimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marr urdhri përmbareimor, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbareueshmërisë. Debitori thekson se përmes faturave të bashkëngjitura si dokumente të besueshme është kërkuar që të paguhet borxhi që është paguar. Më tutje sqaron se duke u bazuar në kartelën financiare, vërtetohet fakti se borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është real dhe se diferenca është në lartësi në shumë prej 2,266.52€ duke e bashkëngjitur kartelën financiare që vërteton faktin se borxhi ndaj kreditorit është në shumën prej 27,271.47€. Më tutje debitori thekson se faturat e bashkëngjitura nuk janë në përputhje me gjendjen faktike dhe si të tilla dokumentin e besueshëm e bëjnë pa tipare te përmbareueshmërisë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar, të anuloj në tërësi urdhrin përmbareimor të Përmbareusit Privat Irfan I. Kërçagu, me numër, P.nr.775/23, i lejuar me datë 03.11.2023 dhe të obligohet kreditori të paguaj shpenzimet e procedurës për përpilimin e prapësimit në shumën prej 312.00€ sipas tarifës së OAK, si dhe shpenzimet tjera që do të krijohen deri në përfundim të procedurës përmbareimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit si të pabazuara, me arsyetimin se pretendimet e debitorit se faturat nuk janë në përputhje me gjendjen faktike dhe se shuma e saktë e borxhit është në vlerë prej 27,271.41.00€ nuk qëndrojnë si të tilla sepse në bazë të faturave të bashkëngjitura në propozim për përmbareim shuma del të jetë 29,537.99€, për më tepër debitori përmes prapësimit ndaj urdhrin përmbareimor ka kërkuar që të shfuqizohet Urdhri Përmbareimor P.nr.775/23 i datës 03.11.2023 mirëpo i njëjti në prapësim vërteton faktin

se ndaj kreditorit ka borxh në shumën prej 27,537.99€. Më tutje thekson se pretendimi i debitorit se një pjesë e detyrimit është përmbushur nuk është i bazuar sepse nga faturat shihet qartë se pagesa e borxhit nuk është përmbushur në shumën totale prej 29,537.99€, mirëpo pasi debitori ka pranuar borxhin në shumën prej 27,537.99.00€, ka kërkuar nga përmbaruesi privat që të zhvillojë procedurën përmbimore për shumën e pohuar në vlerë prej 27,537.99€. Gjykatës i propozon që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, të lë në fuqi urdhrin përmbimor, P.nr.775/23, i lejuar me datë 03.11.2023 nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu dhe të obligohet debitori ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbimore dhe atë për përpilimin e propozimit për përmbimorim në shumën prej 312.00€, përgjigjes në prapësim në shumën prej 624.00€ dhe shpenzimet e tjera të procedurës që do të krijohen.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbimorin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbimorin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbimorim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbimorimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbimorim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbimorim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbimorimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturën me numër 22-SHV01-001-56 të datës 01.10.2022, Faturën 22-SHV01-001-65 të datës 01.11.2022, Faturën 23-SHV01-001-5 të datës 01.02.2023, Faturën 23-SHV01-001-11 të datës 01.03.2023, Faturën 23-SHV01-001-18 të datës 01.04.2023, Faturën 23-SHV01-001-26 të datës 01.05.2023, Faturën 23-SHV01-001-28 të datës 01.06.2023, Faturën 23-SHV01-001-37 të datës 01.07.2023, Faturën 23-SHV01-001-42 të datës 01.08.2023, Faturën 23-SHV01-001-44 të datës 01.09.2023 dhe Faturën 23-SHV01-001-47 të datës 01.10.2023, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është i përshkruar objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e protokollimit të debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, andaj vendosi që të lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.775/23, të datës 03.11.2023, të lejuar nga Përmbaruesit Privat Irfan I. Kërçagu, për shumën e përgjithshme prej 29,537.99€.

Gjykata, i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e debitorit se ka obligim ndaj kreditorit vetëm shumën prej 27,271.47€, pasi që nga faturat në bazë të cilave është lejuar urdhëri përmbarimor arrijnë shumën prej 29,537.99€.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që vendosi që të obligoj debitorin që kreditorit ti paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë 208 euro në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim dhe 208 në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, kjo në përputhje me tarifën e OAK – përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10,000.00€ e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2084/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.